

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

**NIVELI I ZHVILLIMIT TË AFTËSIVE NË NGRITJEN E
AFTËSIVE MOTORIKE DHE SITUACIONALE NË HENDBOLL
KH “PRISHTINË”**

**Mentori:
Dr. Asis. Afrim Koca**

**Kandidatja:
Burneta Rama**

Prishtinë, 2017

DEDIKIM

PRINDIT

Për të tjerët është e lehtë dhe të thonë se do të bëhët më e lehtë, por unë e di se zemra akoma dhemb.

Mungesa jote është e pranishme dhe e tillë do të jetë përgjithmonë, askush dhe asgjë nuk të zëvendëson.

Ti ishe gjithmonë i forte, i rreptë, i menqur, luftarak, i dashur vetit të cilat i kam trashëguar nga ti.

Ashtu siq luftove në luftime dhe kurr nuk u dorëzove ashtu edhe unë do të mundohem të ndjekë hapat e tu.

Ti me frymëzove dhe me mësove së qfarë do të thotë jeta. Familja jote është krenare dhe mburret për veprat e tua të cilat kanë lanë gjurmë jo vetëm në jetën tonë por në mbarë Kosovën.

Tash më në atdheun tonë të lire dhe të tillë e doje, ne po korrim suksese në lëmit tona, që sigurisht do ndiheshë shumë krenar për ne.

Të falimderoj, që na mësove të jetojmë jetën me gjithë fuqinë tonë, të ndertojmë gjithçka nga themeli e deri te kulmi, të cilin unë ende nuk e kam arritë por, të premtojë se kur të arrijë në kulminacion do të dijnë të gjithë se është merita e jote i dashuri baba.

Të shkruaj për ty nuk do të këtë mbarim asnjëherë, nuk ka fjalë as fjali apo shkrim që do të përkufizojë ty si njeri që ishe.

Dashuria për ty është sa numri i yjeve në univers.
Më mungon.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
1.2 HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË TRAJNINGUT KONDICIONAL	9
2. QËLLIMI I PUNIMIT	11
3. HIPOTEZAT THEMELORE	12
4. MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARAVE/	13
4.1 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	13
4.1.1 Ndryshoret prediktore të forcës eksplozive	13
4.1.2 Ndryshoret e fleksibilitetit	14
4.1.3 Ndryshoret e forcës statike.....	14
4.1.4 Ndryshoret motorike situacionale	14
4.2 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE	15
4.2.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës eksplozive.....	15
4.2.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të fleksibilitetit	21
4.2.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës statike.....	25
4.2.4 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike situacionale.....	31
4.3 METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE	37
5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI	38
5.1 INTERPRETIMI I REZULTATTEVE TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË PËRGATITJEVE	38
5.1.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE HENDBOLLISTET PARA FAZËS PËRGATITORE.....	38
5.1.2 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FLEKSIBILITETIT TE HENDBOLLISTET PARA FAZËS PËRGATITORE.....	42
5.1.3 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE HENDBOLLISTET PARA FAZËS PËRGATITORE	44
5.1.4 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE SITUACIONALE TË PRECIZITETIT TE HENDBOLLISTET PARA FAZËS PËRGATITORE	47
5.2 INTERPRETIMI I REZULTATTEVE TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	51
5.2.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	51
5.2.2 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FLEKSIBILITETIT TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	54
5.2.3 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	56
5.1.4 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE SITUACIONALE TË PRECIZITETIT TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	59
5.2 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE	63

5.2.1 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	63
5.2.2 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FLEKSIBILITETIT TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	65
5.2.3 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	66
5.2.4 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË SITUACIONALE TË PRECIZITETIT TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	68
5.2.5 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	71
5.2.6 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FLEKSIBILITETIT TE HENDBOLLISTET PAS FAZËS PËRGATITORE	72
5.2.7 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE HENDBOLLISTET PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS PËRGATITORE	73
5.2.8 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE SITUACIONALE TË PRECIZITETIT TE HENDBOLLISTET PAS FAZËS PËRGATITORE	75
5.3 DALLIMET NË REZULTATET E NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE, FLEKSIBILITETIT, FORCËS STATIKE DHE MOTORIKE SITUACIONALE TË PRECIZITETIT TE HENDBOLLISTET PARA DH PAS FAZËS PËRGATITORE	77
5.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE	79
6. PËRFUNDIMI	80
7. LITERATURA	82
REZYME	83
SUMMARY	84

1. HYRJE

Në çdo sport, edhe në lojën e hendbillit plani dhe programi stërvitor janë dokumente themelore sipas së cilave realizohet procesi i përgatitjes kondicionale dhe kontrollohen efektet të cilat arrihen me aplikimin e tyre. Procesit stërvitor dhe funksionimi optimal në procesin parapërgatitor duhet që të mos pësojnë situata kaotike. Me procesin stërvitor mund të udhëheqet me sukses dhe të rregullohet nëse janë më parë të vërtetuar qëllimet, detyrat, ciklet kohore dhe kushtet e realizimit, por gjithashtu edhe nëse janë të definuar përmbajtjet e ngarkesave, metodat e punës, lokaliteti (vendi) rekuizitat stërvitore të cilat aplikohen, renditen ose radhiten gjatë periudhës kohore për të arritur efekte të dëshiruara dhe rezultate më të larta sportive.

Hulumtimet e shumta shkencore sidomos të viteve të fundit kanë vërtetuar dhe shpjeguar rëndësi e madhe që ka përgatitja fizike si faktor i cili në masë të madhe determinon suksesin në aktivitetin sportiv. Rezultatet e larta kulminante mund të arrihen vetëm gjatë një procesi stërvitor të gjatë dhe të organizuar mirë, i cili i është nënshtruar ligjeve të zhvillimit bio-psiko-social si dhe stimuluesve stërvitor të mundshëm dhe të nevojshëm për zhvillimin dinamik të aftësive bazike dhe specifike, cilësive dhe njohurive të hendbollisteve.

Për lojën e hendbollit është e domosdoshme që të bëhet periodizimi i punës dhe programi kondicional duke i respektuar specifikat e çdo sporti respektivisht, duhet të zhvillojmë ata faktorë të cilët më së tepërmi do të kontribuojnë në suksesin e përgjithshëm tek sportet gjegjësisht. Për optimalizimin e procesit të përgatitjes kondicionale hulumtuesit sportiv si dhe ekspertët e ndryshëm tentojnë të grumbullojnë sa më tepër informacione për aktivitetin konkret sportiv si dhe mbi strukturën e kërkuar të karakteristikave antropologjike të sportistit. Për volejbollit, më shkurt mund të thuhet që është sport kompleksë të cilën e përbëjnë lëvizjet komplekse të thjeshta dhe të përbëra, dhe se këto lëvizje i ekzekutojnë anëtarët e ekipit në kushtet e bashkëpunimit si dhe kundërvënies ekipit kundërshtarë gjatë lojës. Me përjashtim, duhet pasur parasysh në gjendjen e aftësive motorike të hendbollisteve.

Meqenëse hendbolli është sport kompleks, parashtrihen kërkesa dukshëm të mëdha në aftësitë psikomotorike. Përpos vërtetimit të kontributit të çdo aftësie motorike

është me rëndësi të vërtetojmë edhe raportet optimale në mes të gjitha aftësive motorike, me ç rast fitohen informacionet mbi përgatitjen integrale. Sistemin e përgatitjes sportive të hendbollistëve e përbëjnë sistemi i treningut, sistemi i garave dhe sistemi i faktorëve plotësues. Sistemi i përgjithshëm i përgatitjes së hendbollistëve është i orientuar në zhvillimin dhe mbajtjen e aftësive të përgjithshme, cilësive dhe njohurive nga të cilët varet suksesi në kushtet e garave.

Si në lojërat e tjera sportive apo ekipore sportive, edhe në lojën e hendbollit suksesi varet nga shumë faktorë të ndërlikuar dhe të ndërlidhura:

1. Përgatitjes teknike
2. Përgatita taktike dhe vendim-marrjes në lojë
3. Përgatitja fizike
- 4 Përgatita psikologjike dhe rezistenca mendore
- 5 Karakteri dhe aftësitë e komunikimit
- 6 Strategjia dhe plani i lojës

Periudha e përgatitjes së përgjithshme është ndër periudhat e cila është e para që duhet ti përgatis dhe ti fus në vazhdomsinë e periudhave tjera përgatitore volejbollistët. Kjo periudhë ose fazë e përgatitjes ndahet në tri etapa përgatitore (etapa ose faza e përgjithshme, faza e përgatitjes bazike dhe faza e përgatitjes speciale).

Qëllimi kryesor i përgatitjes kondicionale në fazën përgatitore, në aspektin e ngritjes së aftësive motorike dhe atyre situacionale në lojën e hendbollit është që të përmirësohet aftësia garuese duke rritur prodhimin e energjisë gjatë aktiviteteve të caktuara. Ndërsa objektivat specifike të sportistëve të përfshirë në disiplina të ndryshme sportive mund të ndryshojnë, pra edhe në lojën e hendbollit.

Janë dy parime të përgjithshme për secilën stërvitje: të përcaktohet sistemi kryesor energjetik që prodhon energji për një aktivitet të caktuar sportive, dhe të konceptohet një program stërvitor që do të “ngarkojë” këtë sistem ashtu që të rrit forcën eksplozive në kuadër të përgatitjes kondicionale në fazën përgatitore.

Për të arritur rezultate të mira hendbollistët duhet të stërviten (ushetrojnë) në një nivel që kalon atë të nevojshme për të përmirësuar rezultatet e mëparshme dhe shëndetin. Programi i duhur i përgatitjes kondicionale të hendbollistëve, e cila përfshin periudha të

caktuara të aktivitetit fizik dhe rimëkëmbjen e duhur, mund të çojë në përmirësimin e aftësisë garuese (rezultatet), rritjen e rezistencës ndaj lëndimeve të lidhura me aktivitetet sportive dhe për të rritur motivimin për stërvitje. Mungesa e lëndimeve e lidhur me aktivitetin sportiv nuk është qëllim real, por programi i rregullt kondicional, sidomos gjatë pushimit të garimit dhe periudhën para-sezonale ka gjasa të rritet rezistenca e sportistëve ndaj lëndimeve dhe për të reduktuar peshën e lëndimit (nëse vjen deri te kjo), si dhe të zvogëlojë rrezikun e mbingarkesës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për hendbollistet ambicioz të reja që kanë një rrezik më të madh për lëndime.

Reagimi i hendbollistëve ndaj stërvitjeve kondicionale është e ndryshme dhe varet nga shumë faktorë siç janë: mosha, gjendja shëndetësore, të ushqyerit, potencialit gjenetik dhe gjendjes fillestare kondicionale. Një nga faktorët që kanë ndikim më të madh është gjendja fillestare kondicionale e sportistëve. Në përgjithësi, sportistët që në start kanë gjendje fillestare kondicionale të ulët kanë progres më të lartë se ata që të fillojë me një programin stërvitor me gjendje kondicionale më të mirë. Për shembull, pas disa muajsh stërvitjeje individët e rritur sedenter mund të përmirësojnë nivelin aerobik kondicional për më shumë se 50%, ndërsa përmirësimi te sportistës e stërvitur vetëm 3% për të njëjtën periudhë. Megjithatë, kjo 3% do të thotë ndryshimi ndërmjet asaj se nëse dikush do të fitojë vendin e parë ose fare nuk do të kualifikohet.

Përgatitja stërvitore e hendbollistëve kërkon njohjen e parimeve bazë të stërvitjes, llojet e stërvitjeve, dhe qëllimet personale të hendbollistëve. Mjekët dhe trajnerët duhet të jenë të vetëdijshëm për veçoritë fizike dhe psikologjike të hendbollistëve të reja. Intensiteti dhe vëllimi i shumicës së programeve të stërvitjeve për të rritur është i papërshtatshëm dhe potencialisht e rrezikshme për hendbollistet e reja dhe në fazën e adoleshencës të cilat ende janë duke kaluar nëpër procesin e ndryshimit të lidhur me rritjen dhe pjekurinë e vet. Parimet e trajnimit janë: specifikimi, mbingarkesat, progresioni, superkompensimi, kthyeshmëria, dhe reduktimin dhe periodizimi. Specifikimi do të thotë se përgjigjet e menjëhershme dhe të mëvonshme, si dhe adaptimi ndaj stërvitjes, në aspektin metabolik dhe biokimik janë specifike për llojin e aktivitetit sportiv që është praktikuar dhe grupet e muskujve që janë të përfshirë në të. Në muskujë gjatë ushtrimeve të llojit të qëndrueshmërisë rritet numri i kapilarëve dhe mitokondrijeve, me çka rritet kapaciteti për krijimin e energjisë aerobe, dhe kur muskujt kryejnë punë të

rënda me pasha të mëdha të llojit të forcës adaptimi primar është në rritjen e fijeve të kontrahimit muskular (proteinike), por nëse muskujt kryejnë punë të shpejta me kohëzgjatje të shkurtër (ushtrime pliometrike) atëhere rritet shpejtësia e reagimit të muskulit (intensiteti i ekscitimit). Ky fenomen quhet "përshtatja ose adaptimi specifik në kërkesat e parashtruara" (engl. specific adaptation to imposed demands, SAID). Njohja e kërkesave të veçanta metabolike të aktivitetit fizik apo sportive është e nevojshme, sepse për shembull, një vrapues sprinter ose peshëngritës, ka pak apo dobi nëse rrit a kapacitetin aerob a injoron kapacitetin anaerob. Stërviçja aerobe mund edhe të zvogëlojë shpejtësinë dhe forcën e sportistëve i cili merret me sportin e tipit anaerob.

Parimi i mbingarkimit bazohet në stërviçjen e cila është e intensitetit më të lartë nga ajo që sportisti është mësuar ose ka ushtruar. Mbingarkimi mund të arrihet duke rritur, frekuencën, intensitetin ose kohëzgjatjen e aktivitetit fizik. Deri te adaptimi mund të arrihet kur muskuli dhe sistemi fiziologjik nuk janë më të mbingarkuara, dhe pastaj, në të kundërtën, edhe programi mirë i dozuar i trajnimit bëhet më pak efikas në lojën e hendbollit.

1.2 HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË TRAJNINGUT KONDICIONAL

Në vendet e ndryshme të Evropës dhe ato Angloamerikane hulumtimet në sporte të ndryshme janë të shumta. Ato kryesisht janë të orientuara në drejtim të gjetjes së stimulatorëve dhe operatorve më të përshtatshme kineziologjike në arritjen e rezultateve sa ma të mira në lojën e voleybollit. Gjatë historisë shpesh është hasur në termin pliometri dhe stërvitja pliometrike, në kuadër të përgaditjes kondicionale, si koncept i vetëm ose nën emërtime tjera, apo aspak s'është ditur për udhëheqje të tillë të trajnimit. Njerëzit ndoshta kanë vlerësuar gjithmonë forcën fizike dhe që nga kohërat e lashta, sportistët kanë kërkuar metoda për të përmirësuar shpejtësinë dhe forcën. (Bompa, 1993).

Ka dëshmi për atë se në kohën e mesme të vjetër figura qëndrore historike Teutobof thuhet se ka kërcyer pesë kuaj që ka qenë tregues i nivelit të lartë të forcës eksplozive (Bompa, 1993). Gjithashtu para 2500 viteve Grekët kanë shfrytëzuar topin të ngjajshëm sikur topi medicinal në lojra të ndryshme dhe përgaditjen fizike dhe ka të ngjarë të kenë përdorur ushtrime të caktuara të hedhjes çka ishte gjithashtu ishte një lloj i trajnimit pliometrik që ka pasur për qëllim rritjen e forcës eksplozive (Bompa, 1993). Egjiptianët gjithashtu kanë përdorur topa në të njëjtën mënyrë 2000 vjet para grekëve (Bompa, 1993). Në Evropë në vitin 1470 në qytetin gjerman të Augsburg në kërcim së gjati ka fituar Princi Christoph nga Bavaria (Bompa, 1993). Pionierët e aplikimit të metodës pliometrike në kuadër të përgaditjes kondicionale në fazën përgatitore, me siguri ka të ngjarë të jenë trajnerët e atletikës në vitet e 20 - dhe 30-ta të shekullit të kaluar dhe kanë futur stërvitje të kërcimeve si pjesë të stërvitjeve të cilat i kanë zhvilluar në palestër gjatë dimrave të gjatë në Evropën lindore dhe veriore (Bompa, 1993).

Në vitin 1933 Akademia Kombëtare Rumune për arsimin fizik ka botuar librin "Trajnimi i kërcimeve për atletët." (Bompa, 1993), ndërsa më vonë Yuri Verhoshansky në vitin 1960 ka theksuar se individët mund të përmirësojnë dukshëm aftësitë fizike të kërcimit dhe sprintit përmes stërvitjeve progresive me kërcime. Trajnimi dhe performancat e sportistëve të tilla si Valeri Borzov, kanë ndihmuar këtë pohim (Chu, 1992). Verhoshansky eksperimentoi me përdorimin e llojeve të ndryshme të pliometris në lidhje me përmirësimin e forcës shpërthyese. Ka argumentuar një përmirësim në tërë sistemin neuro - muskolor dhe shpejtësin e tkurrjes (Bompa, 1993).

Në fillim të viteve të 80 - ta, studiuesit Russ Polhemus, Ed Burkhardt dhe të tjerët kanë treguar se me kombinimin e trajnimeve pliometrike dhe programit të trajnimit me peshe përmirësohet zhvillimin fizik shumë më lartë se sa arrihet me trajnim vetëm me pesha (Chu, 1992). Në vitet e 70 – ta dhe 80 – ta shumë hulumtues, veçanarisht në Finlandë, Itali, USA dhe Gjermani në hulumtimet e tyre kanë treguar se përfitimet fiziologjike janë evidente nga trajnimi reaktive ose pliometrik (Cavagna, 1970; Komi dhe Buskirk, 1972; Bosco me bashkëpunëtor.,1976; Blattner dhe Noble, 1979; Bosco me bashkëpunëtor., 1981, 1982; Schmidtbleicher dhe Gollhofer, 1982; Clutch me bashkëpunëtor, 1983; Schmidtbleicher,1984; Gollhofer me bashkëpunëtor, 1987). Gjithashtu këtu hyjnë edhe autorë të tjerë të cilët botuan numër të madh të artikujve dhe libra për këtë temë (Wilt, 1978; Chu, 1983, 1984; Radcliffe dhe Farentinos, 1985;) (Bompa, 1993). Termi pliometri është përdorur për herë të parë nga ana e Fred Wiltës, njëri nga trajnerët më të mirë amerikanë të atletikës (Chu, 1992). Ekziston informacioni për atë që supozohet se ishte sekreti i suksesit të fituesit në 100 Valery Borza 1972, i cila ka arritur të përmirësojë rezultatin prej 13,00 sek. në 10,00 sek. më trajnimin pliometrik (Chu, 1992). Studimet e para mbi zhvillimin e kontrahimeve ekscentrike - koncentrike i kan kryer Flitney dhe Hirst (1978) të muskuli i izoluar i bretkocës (Zatciorsky, 1995), ndërkohë që efektin pozitiv të veprimit të zgjatjes së mëparshme të karakteristikat kontrahuese të muskujve në situata motorike kanë vërtetuar Bonde Petersen (1974), Cavagna (1974) dhe Verkoshansky (1977). (Bompa, 1993). Disa autorë theksojnë se rusët kanë shpikur pliometrinë, por kjo është e gabuar, sepse çdo fëmijë i cili kërcen mbi litar ose duke luajtur "lojë fëmijësh me kërcime" është në fakt pliometri. Gjithashtu cili do kërcim nga gjimnastika ka të bëjë me pliometrinë, dhe nga kjo pikë historike referimi kemi treguar për ekzistencën e plyometris dhe trajnimit plyometrik. Gjitha kërcimet si elemente teknike në lojën e hendbolit përkasin pliometrisë.

Njeriu gjatë çdo ecjeje dhe vrapimi, dhe çdo formë të kërcimeve ose duke e shtyrë dhe hedhur përdor e kontrahimin pliometrik dhe në këtë mënyrë një lloj të veçantë të trajnimit pliometrik. Por, nga të gjitha sportet, loja e hendbollit kërkon shkëputje të larta me qëllim të mbizotërimit në rrjetë dhe gjetjes së hapësirës më të lirë gjatë gjuajtjes. Për këtë qëllim ushtrimet pliometrike ose të forcës eksplozive elastike zënë rëndësi të veçantë gjatë përgatitjes kondicionale.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Në lojën e hendbollit ushtrimet ose stërvitjet gjatë fazës përgatitore në vazhdimësi kanë pësuar një evolucion të jashtëzakonshëm. Ky evolucion ka ndodhur në sajë të përsosjes së teknikave të reja realizuese dhe metodikave përkatëse, në kushtet e një sigurie të plotë për hendbollistët dhe janë reflektuar me shpejtësi në përmbajtjen e programeve dhe organizimin e procesit stervitorë.

Metodat e reja karakterizohen nga një shpejtësi e konsiderueshme e gjindshmëris, duke shfrytëzuar në maksimum dhe me saktësi të madhe parimet biomekanike që rregullojnë të gjitha format e lëvizjes si dhe gjindshmëris në lojë.

Duke u nisur nga këto fakte të prezentuara rreth përgatitjes së hendbollistëve në fazën përgatitore, qëllimi i këtij punimi është vërtetimi i ndikimit të fazës përgatitore te hendbollistët kulmore në ngritjen e disa aftësive motorike, forcës eksplozive, fleksibilitetit, forcës statike dhe situacionale. Vërtetimi i përgatitjes fizike do të bëhet duke krahasuar rezultatet e gjendjes fillestare (në fillim të fazës përgatitore) dhe gjendjes finale (pas përfundimit të fazës përgatitore) te hendbollistët e KH “Prishtina” pjesëmarrëse në Superligën e Kosovës.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit dhe metodat kuantitative për përpunimin e rezultateve do të parashtrohen këto hipoteza:

H1- Pritet që distribucioni i fituar i ndryshoreve të aftësive motorike dhe ndryshoreve situacional nuk do të kenë shmangie nga distribucioni normal në nivel $p=0.05$.

H2 – Pritet që Korelacionet brenda ndryshoreve të aftësive motorike dhe ndryshoreve të situacional do të jenë statistikisht të rëndësishme në nivel $p=0.05$

H3 – Presim që të fitohen dallime të rëndësishme statistikore në rezultatet e ndryshoreve të aftësive motorike dhe ndryshoreve situacionale para dhe pas fazës përgatitore (përgatitjes kondicionale) dhe se këto dallime do të jenë statistikisht të rëndësishme në nivel $p=0.05$.

4. MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARAVE/

Popullata nga e cila do të merret mostra e të testuarave është definuar si popullatë hendbollisteve të Superligës së Kosovës. Mostra ka përfshirë 20 hendbolliste nga KH “Prishtina”. Hendbollistet janë testuar në sallën e qyteti të Prishtinës ku zhvillohen lojërat e hendbollit duke i plotësuar të gjitha kushtet për matje. Hendbollistet janë testuar dy herë, në fillim, domethënë para fazës përgatitore një herë dhe pas fazës përgatitore herën e dytë. Matjet janë kryer në orët e pasdites gjatë vitit kalendarik 2016/17.

4.1 MOSTRA E NDRYSHOREVE

Ndryshoret të cilat janë aplikuar në këtë hulumtim janë ndryshore të natyrës motorike. Janë aplikuar 6 ndryshore të forcës eksplozive, 4 ndryshore të fleksibilitetit, 6 ndryshore të forcës statike dhe 6 ndryshore motorike situacionale të precizitetit.

4.1.1 Ndryshoret prediktore të forcës eksplozive

Për vlerësimin e aftësive motorike të forcës eksplozive janë përfshirë këto ndryshore:

- 1. MKGJVE** – *Kërcim së gjati nga vendi*
- 2. MKLAVE** – *Kërcim së larti nga vendi*
- 3. MKLKED** – *Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë*
- 4. MKLKEM** – *Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë.*
- 5. MHTMSH** – *Hudhja e topit medicinal nga pozita e shtrir*
- 6. MHTMG** – *Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur në karrigë.*

4.1.2 Ndryshoret e fleksibilitetit

Për vlerësimin e aftësive motorike të fleksibilitetit janë përfshirë këto ndryshore:

1. **MFPTPD** – *Përkulje e trupit para nga drejtpërdrejt*
2. **MFPTPA** – *Përkulje e trupit para nga pozita ulur*
3. **MFKASP** – *Këmbët anash (Spaga)*
4. **MFRRDU** – *Rrotullimi i duarve para, lartë dhe prapa.*

4.1.3 Ndryshoret e forcës statike

Për identifikimin e aftësive motorike të forcës statike janë aplikuar këto ndryshore:

1. **MFSGJP** – *Forca statike gjysmë pompë*
2. **MFSVAR** – *Qëndrim në varje në hekur me bërryla të thyer 90°*
3. **MFSQKM** – *Qëndrimi i këmbëve të shtrira mbi top*
4. **MFSQTB** – *Qëndrimi i trupit të shtrirë barkas*
5. **MFSGJU** – *Qëndrimi gjysmë ulur*
6. **MFSGJU1** – *Qëndrimi gjysmë ulur me një këmbë*

4.1.4 Ndryshoret motorike situacionale

Për identifikimin e aftësive motorike situacionale në lojën e hendbollit janë aplikuar këto ndryshore:

1. **MSUT40** – *Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra*
2. **MSUS20** – *Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra*
3. **GJVTPO** – *Gjuajtja nga vendi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra*
4. **GJKTPO** – *Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë 50x50cm nga 9 metra*
5. **VR33GJ** – *Vrapim tri herë rreth 9m me tri gjuajtje*
6. **GJTM1M** – *Gjuajtja e topit në mur brenda një minute*

4.2 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE

4.2.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës eksplozive

1. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJAV

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dysHEME për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtqëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: E testuara kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu open gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 1. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJAV



2. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE.

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu epen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 2. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE.



3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë - MKLKED

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi. **Përshkrimi i detyrës:**

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, e testuara kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e djathtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë - MKLKED



4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë - MKLKEM

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjës së parë, a testuara kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e majtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjës së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.

Foto 4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë - MKLKEM



5. Hedhja e topit medicinal nga pozita e shtrirë - MHTMSH

Instrumentet: topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur për hedhjen e topit medicinal

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në pozitë të shtrirë, fytyrë nga lartë, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar të shtrira lartë mbi kokë.

Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e të shtrirë me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.

Foto 5. Hedhja e topit medicinal nga pozita e shtrirë - MHTMSH



6. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit - MHTMG

Instrumentet: topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në pozitë drejte, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar në nivel të gjoksit.

Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.

Foto 6. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit - MHTMG



4.2.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të fleksibilitetit

1. Përkulje e trupit para nga drejtqëndrimi - MFPTPD

Instrumentet: Ulësja, metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për ulësen, 40 cm nën tavolinë dhe 40 cm mbi tavolinë. .

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron mbi ulsën , me këmbë të drejta, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

Realizimi i detyrës: E testuara në përkulje të thellë dhe këmbë të drejta, në maje te gishtërinjve të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. E testuara e mban pozitën e fundit që leximi te jetë sa më i saktë.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës
Për vlerësimin e aftësive motorike të fleksibilitetit janë përfshirë këto ndryshore:

Foto 7. Përkulje e trupit para nga drejtqëndrimi - MFPTPD



2. Përkulje e trupit para nga pozita ulur - MFPTPA

Instrumentet: Metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për dysheme me gjatësi 2 m

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron ulur në dysheme, shpina dhe koka të mbështetur për muri, këmbët e hapura anash, duart paralelisht njëra me tjetrën në pozitën para poshtë takojnë dyshemenë. Pika ku prekin majat e gishtërinjve vendoset shiriti metrik (pika 0).

Realizimi i detyrës: E testuara në përkulje të thellë dhe këmbë të drejta anash, në maje te gishtërinjve të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, tenton të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. I testuara e mban pozitën e fundit që leximi te jetë sa më i saktë.

Vlerësimi: Testi përsëritet dy herë. E testuara e mban pozitën e fundit që leximi te jetë sa më i saktë. Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë. Saktësia e matjes 0.1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës

Foto. 8 Përkulje e trupit para nga pozita ulur - MFPTPA



3. Këmbët anash (Shpaga) - MFKASP

Instrumentet: Metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për dysheme me gjatësi 2 m

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në drejtqëndrim

Realizimi i detyrës: fillon me hapjen e këmbëve anash. Mbrapa të testuarit qëndrojnë dy matës me shiritin metrik dhe atë, njëri afër thembrës së djathtë e tjetri afër thembrës së majtë. Në momentin kur i testuari bënë me shenjë se nuk mundet më shumë të bëjë hapjen, atëherë matësit me shpejtësi tërheqin shiritin metrik dhe tregojnë rezultatin. Pika zero është në mes të njëres thembër, si dhe pika përfundimtare në mesin e thembrës tjetër.

Vlerësimi: Testi përsëritet dy herë. E testuara e mban pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë. Shënohet rezultati i hapjes më të thellë. Saktësia e matjes 0.1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta

Foto 9. Këmbët anash (Shpaga) - MFKASP



4. Rrotullimi i duarve para, lartë dhe prapa - MFRRDU

Instrumentet: Shkopi i gjatësisë prej 2 metrave i shënuar me shenja të metrit milimetrikë.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në drejtqëndrim dhe kap shkopin me dy duar. Dora e djathtë është e vendosur në skajin ku është e vendosur pika zero kurse e majta varësisht prej fleksibilitetit të krahavorit të testuesit.

Realizimi i detyrës: E testuara fillon me ngritjen e duarve lartë mbi kokë. Para të testuarit qëndron matësi. Në momentin kur i testuari kap shkopin me dy duar fillon të rrotulloj duart prapa. E testuara rrotullon duart para dhe i kthen prapë në pozitën fillestare. E testuara e mban me dorën e majtë shkopin deri sa të lexohet rezultati i matjes.

Vlerësimi: Testi përsëritet dy herë. E testuara e mban pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë. Shënohet rezultati i hapjes më të thellë. Saktësia e matjes 0.1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

10. Rrotullimi i duarve para, lartë dhe prapa - MFRRDU



4.2.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës statike

1. Forca statike gjysmë pompë – MFSGJP

Instrumentet domosdoshme: detyra ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët dhe pa rekuizita.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara merr pozitën për ekzekutimin e përkuljes në duar. Bërrylat janë të larguar në distancë të caktuar. Llërat janë të vendosura ashtu që gjenden në nivel të kraharorit. Krahët janë të vendosur ashtu që gjenden në vazhdim të nivelit të kraharorit. Trupi me këmbë të shtrira dhe të bashkuara mbështeten në gishtrinjtë e këmbëve.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet deri në pozitën kur llërat gjenden në pozitë paralele me sipërfaqen e mbështetjes. E testuara mundohet që të qëndroj në këtë pozitë sa ma gjatë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës nga momenti kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së caktuar.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 11. Forca statike gjysmë pompë – MFSGJP



2. Qëndrim në varje në hekur me bërryla të thyer 90° - MFSVAR

Instrumentet domosdoshme: Paralele gjimnastikor.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara me paralele merr pozitën për ekzekutimin e qëndrimit me duar të thyera në varje në paralele. Krahët janë të vendosur ashtu që gjenden në vazhdim të nivelit të kraharorit.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet ngritët në duar në pozitën kur llërat dhe parallërat gjenden në pozitë 90°. E testuara mundohet që të qëndroj në këtë pozitë sa ma gjatë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës nga momenti kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së caktuar.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 12. Qëndrim në varje në hekur me bërryla të thyer 90° - MFSVAR



3. Qëndrimi i këmbëve të shtrira mbi top - MFSQKM

Instrumentet domosdoshme: Topi medicinal, kronometri

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuari ulet në dysHEME dhe me duar të vendosura prapa fikson pjesën e trupit gjatë ekzekutimit të detyrës. Topi medicinal është i vendosur nën shputat e këmbëve të shtrira.

Realizimi i detyrës: E testuara këmbët e shtrira dhe të bashkuara i vendos mbi topin medicinal dhe i ngrit në lartësi prej 10 cm mbi top.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur i testuari lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës prej momentit kur e testuara merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i kësaj pozite.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 13. Qëndrimi i këmbëve të shtrira mbi top - MFSQKM



4. MFSQTB – Qëndrimi i trupit të shtrirë me fytyrë nga poshtë

Instrumentet domosdoshme: Ulësja suedeze,

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara e shtrirë me fytyrë nga poshtë në ulësen suedeze, fikson këmbët e shtrira në shpatullore në nivel të dyshekut. Ulësja suedeze është e vendosur paralel me shpatulloren.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet deri në pozitën horizontale barkas, me mbështetje deri te kërdhokullat, dhe në atë pozitë tenton që të qëndroj sa më gjatë.

Kryerja e ekzekutimit: Detyra ndërpritet, atëherë kur i testuari lëshon pozitën horizontale.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati metët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari lëshohet në pozitë horizontale e deri te lëshimi i kësaj pozite.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 14. MFSQTB – Qëndrimi i trupit të shtrirë me fytyrë nga poshtë



5. Qëndrimi gjysmë ulur - MFSGJU

Instrumentet domosdoshme: Testi ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në drejtqëndrim këmbët e hapura në nivel të kërdhokullave.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshon peshën e trupit në pozitën gjysmë ulur ashtu që këndi në mes kofshës dhe kërcirit të jetë 90 shkallë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet atëherë kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së paraparë.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto15. Qëndrimi gjysmë ulur - MFSGJU



6. Qëndrimi gjysmë ulur me një këmbë – MFSGJU1

Instrumentet domosdoshme: Testi ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: Qëndrimi këmbë hapur.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshon peshën e trupit në këmbën e majtë ashtu që në këmbën e majtë pozita e kofshës dhe e nëngjurit të jetë 90 shkallë. Këmba tjetër është e shtrirë në të djathtë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet atëherë kur i testuari lëshon pozitën e parapa.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së paraparë.

Udhëzime të testuari: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës

Foto 16. Qëndrimi gjysmë ulur me një këmbë – MFSGJU1



4.2.4 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike situacionale

1. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40

Instrumentet: Ikonate vendosura në sallë, distanca e ikonave është 40 metra (2 ikona), Topi i hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara në vijën startuese para se të udhëheq topin dhe e përgatitur për ta kaluar distancën sa më shpejt që është e mundur.

Realizimi i detyrës: E udhëheq topin duke i kaluar ikonat, sa më shpejt që është e mundur.

Vlerësimi: Matet shpejtësia e udhëheqjes së topit duke kaluar ikonat sa më shpejt që është e mundur e shprehur në sekonda..

Udhëzime të testuarit. Të testuarit udhëzohen që ta perserisin dy herë me intenzitet të vogël, paraxemje..

Foto17. Udhëheqja e topit me shpejtësi 40 metra – MSUT40



2. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra – MSUS20

Instrumentet: Ikonate vendosur në sallë, distanca e ikonave është 2 metra (10 ikona), Topi i hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara në vijën startuese para se udhëheq topin zig-zag duke kaluar ikonat në formë të numrit tetë sa më shpejt që është e mundur.

Realizimi i detyrës: E udhëheq topin zig-zag duke kaluar ikonat në formë të numrit tetë, sa më shpejt që është e mundur.

Vlerësimi: Matet shpejtësia e udhëheqjes së topit zig-zag duke kaluar ikonat në formë të numrit tetë sa më shpejt që është e mundur e shprehur në sekonda..

Udhëzime të testuarit.. Të testuarit udhëzohen që ta perserisin dy herë me intenzitet të vogël, paraxemje.

Foto 18. Udhëheqja e topit zigzag (sllallom) me shpejtësi 20 metra



3. Gjuatja nga vendi i 10 topave në portë nga 9 metra – GJK10P9M

Instrumentet: Porta e vizatuar në murë, Topi i hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram , Porta e vizatuar në murë, Porta e ndar në 9 katror të vizatuar, nga lartë: 10, 3, 10; fusha e mesme e portësi: 5, 2, 5, fusha e poshtëme e portës 10, 3, 10; dhe Vija e shenuar e largësisë së gjuajtjes prej 9 metrave nga mesi i portës.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuari përgatitet për gjuajtje pranë vijës për gjuajtje nga vendi.

Realizimi i detyrës: E testuari pa vrull pa shpëputje nga vija e gjuajtjes, gjuan topin sa më saktë në katrorin e vendosur në mur në largëso prej 9 metrave.

Vlerësimi: Matet numri i gjuajtjeve të sakta të topit në katrorat e shenuar me numra.

Udhëzime të testuarit. Të testuarat udhëzohen që ta perserisin dy gjuajtje provuese.

Foto 19. Gjuatja nga vendi i 10 topave në portë nga 9 metra – GJK10P9M



4. Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra – GJK10P9M

Instrumentet: Porta e vizatuar në murë, Topi i hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram , Porta e vizatuar në murë, Porta e ndar në 9 katror të vizatuar, nga lartë: 10, 3, 10; fusha e mesme e portësi: 5, 2, 5, fusha e poshtëme e portës 10, 3, 10; dhe Vija e shenuar e largësisë së gjuajtjes prej 9 metrave nga mesi i portës.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuari përgatitet për gjuajtje pranë vijës për gjuajtje nga kërcimi.

Realizimi i detyrës: E testuari pa vrull me shkëputje nga vija e gjuajtjes, gjuan topin sa më saktë në katrorin e vendosur në mur në largëso prej 9 metrave.

Vlerësimi: Matet numri i gjuajtjeve të sakta të topit në katrorat e shenuar me numra.

Udhëzime të testuarit. Të testuarat udhëzohen që ta perserisin dy gjuajtje provuese.

Foto 20 . Gjuajtja nga kërcimi i 10 topave në portë nga 9 metra – GJK10P9M



5. Vrapim tri here rrethë 9m me tri gjuajtje (VR3x3x3GJ)

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. 3 topa të hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram dhe porta e hendbollit.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: E testuara përgatitet pranë vijës për start të ekzekutimit të detyrës, në pozitë të drejtëqëndrimit në vijën e fundit të portës, domethënë ku bashkohet vija fundore e 9 metërshit ku janë të vendosur 3 topa të hendbollit. Vija e startit është te vija ku takohen vija e 9 metërshit me vijën anësore. Në vijën e 9 metërshit përballë vijës së 7 metërshit vendosen në parket 3 rroathë me diametër 1m, në distancë prej 1 metër larg njëri-tjetrit.

Realizimi i detyrës: E testuara ka për detyrë që nga vija e startit të të marr topin të udhëheq në vrapë sa më shpejtë që është e mundur dhe ta gjuaj në portë nga rrethi i parë, të vazhdojë vrapimin deri te vija tjetër anësore ku takohen vija e 9 metërshit të vrapoj në drejtim të startit, të marr topin e dytë dhe kështu të vazhdojë pa ndërprerë derisa t'i kryej tri gjuajtjet me top në portë.

Vlerësimi: Në fletëtestim rezultatet shënohen me saktësi prej 0.1 sec.

Udhëzime të testuarit. Të testuarit udhëzohen që ta perserisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

Foto 21. Vrapim tri here rrethë 9m me tri gjuajtje (VR3x3x3GJ)



6. Gjuajtja e topit në mur brenda një minuti (GJTM1M)

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. Topi i hendbollit me perimenter 56cm me peshe 450 gram, shiriti metrik për shënimin e gjatësisë 6m nga muri dhe katrori 50 x 50 cm në lartësi 1 m nga dyshemeje.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara përgatitet për gjuajtje pranë vijës për gjuajtje nga drejtpërdrejt.

Realizimi i detyrës: E testuara pa vrull dhe pa shpëputje nga vija e gjuajtjes, gjuan topin sa më shpejt në katrorin e vendosur në mur gjatësi prej 6 metrave.

Vlerësimi: Matet numri i gjuajtjeve të sakta të topit në katror brenda 1 minute.

Udhëzime të testuarit. Të testuarit udhëzohen që ta perserisin dy here gjuajtjen si gjuajtje provuese.

Foto 22. Gjuajtja e topit në mur brenda një minuti (GJTM1M)



4.3 METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit.

Për sistemin e variablave variablave të forcës eksplozive, fleksibilitetit dhe variablave të precizitetit situacional do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- Vlerat minimale dhe maksimale (**R.min-R.maks**),
- Mesatarja aritmetikore (**Ma**),
- Devijimi standard (**Ds**) dhe
- Parametrat e asimetrisë (**SKEW dhe KURT**).

Distribucioni normal i rezultateve të fituara nga vlerësimi i ndryshoreve motorike dhe situacionale do të testohet me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW).

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet variablave të forcës eksplozive, fleksibilitetit dhe variablave të precizitetit situacional në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

Për percaktimin e dallimit ndërmjet variablave të forcës eksplozive, forcës statike, fleksibilitetit dhe variablave të precizitetit situacional në fillim dhe pas fazës përgatitore do të aplikohet analiza e **t-testi** për grupin e varur.

5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI

5.1 INTERPRETIMI I REZULTATTEVE TE HENDBOLLISTET PARA FILLIMIT TË PËRGATITJEVE

5.1.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE HENDBOLLISTET PARA FAZËS PËRGATITORE

Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve motorike të forcës eksplozive, të hendbollistëve të KH „Prishtina“ nga Prishtina për fazën përgatitore. Mostra ka përfshirë grupin 20 hendbollistëve të gjinisë femërore seniorë, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetike, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Distribucioni normal i rezultateve të fituara nga vlerësimi i ndryshoreve motorike dhe situacionale është testuar me anë të metodës së Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW).

Mesatarja aritmetike e ndryshores kërcim së gjati nga vendi (MKGJVE) është 197.85 cm. Rezultati minimal (171.00 cm) dhe ai maksimal (230.00 cm) i ndryshores kërcim së gjati nga vendi tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes hendbollistëve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një asimetri të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Hendbollistët në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet nuk kanë shpërndarje nga distribucioni normal.

Mesatarja aritmetike e ndryshores kërcim së larti nga vendi (MKLAVE) është 45.25 cm. Rezultati minimal (36.00 cm) dhe ai maksimal (52.00 cm) i ndryshores kërcim së gjati nga vendi tregojnë se ekziston një dallim i theksuar në mes hendbollistëve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një asimetri të lehtë të ndryshores ka

rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Hendbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar. Testi i Kolmogorovit-Smirnovit (KS) dhe Shapiro-Wilkut (SHW) tregojnë se rezultatet nuk kanë shmangie nga distribucioni normal.

